

“Internimet politike të shqiptarëve gjatë pushtimit italian, profilet antifashiste gjatë luftës dhe pas saj”.

Znj. Ardita Repishti, Istituto Storico Italiano per l’Età Moderna e Contemporanea

Tema është frymëzuar nga një punim i zgjeruar për Institutin Italian për Historinë Moderne dhe Bashkëkohore, në varësi të Ministrisë Italiane të Kulturës.

Projekti i zgjeruar i Bashkimit European i kthehet Ventotenes, burgut ku që në 1941 u parashikua Europa e Bashkuar, përtej ideologjive e nacionalizmave, ku shtetet do të bashkëjetonin në paqe e harmoni, duke kapërcyer ndasitë e mëdha të së shkuarës, kryesisht të shkaktuara nga regjimet totalitare, duke mbajtur përgjegjësi dhe duke respektuar dinjitetin njerëzor.

Federalistët Altiero Spinelli, eurodeputet dhe bashkautor i Manifestit të Ventotenes dhe Presidenti italian Alessandro Pertini janë nga të mbijetuarit e Ventotenes, që kanë dokumentuar lidhjet e tyre të afërta me jo pak shqiptarë elitarë të dënuar, mes të cilëve Zai Fundo e Gani Kryeziu e vëllezërit, për të cilët Pertini u interesua personalisht që të mund të largoheshin nga ishulli në gusht të 1943.

Puna për zbardhjen e emrave antifashistë të dënuar në Ventotene dhe ishujt e tjerë, është në fakt e lidhur me personalitete të dënuara nga të dy sistemet, fashizmi e komunizmi, për shkak të dritës që përcillnin, të forcës intelektuale dhe të ndikimit të fuqishëm të tjerët.

Nga rreth 130 veta të dënuar në Ventotene, gati gjysma e tyre u ridënua pas kthimit në Shqipëri dhe vendosjes së regjimit komunist. Një pjesë u asgjësuan pa mbaruar ende lufta, si Safet Butka (shtator 1943), Zai Fundo (shtator 1944) Ismail Karapici (shkurt 1944).

Një pjesë u larguan nga atdheu me vendosjen e regjimit, si Isuf Luzaj, (bashkëthemelues i Ballit Kombëtar dhe i Partisë Socialdemokrate), Abaz Ermenji (Balli Kombëtar) apo profesor Stavro Skëndi (Legaliteti). Familjet e tyre në Shqipëri ishin ato që vuajtën zgjedhjen e profesorëve që shkëlqyen në Perëndim.

Të tjerë u dënuan në vend, me vdekje, me burg, me internim, mosushtrim të të drejtave e lirive, mohim të pronësisë intelektuale... Mes tyre avokati Myzafer Pipa (i vdekur në hetuesi), kimisti Niko Lezo (i pushkatuar me intelektualët e

bombës në ambasadën sovjetike) Faik Shehu (pushkatuar me grupin e deputetëve), Fazli Frashëri (pushkatuar me pjesëmarrësit e Kongresit të Lushnjës), nacionalisti pejan Osman Taraku (pushkatuar nga gjyqi ushtarak i 1945), nacionalisti Ndue Pali (pushkatuar si eksponent i Ballit në 1945), Hasan Reci (pushkatuar me grupin e dytë të deputetëve në 1948), shkrimtari Petro Marko (dënuar me burg, survejuar gjithë jetën, hequr disa herë e drejta e botimit) gjuhëtari Selman Riza (zotërues i 12 gjuhëve të huaja) transliteruesi i teksteve arbëreshe Izet Bebeziqi (zotërues i 11 gjuhëve të huaja), Dan Hasani (dënuar familjarisht), prof. Dr. Sulejman Lleshi, atentator në tentativë i Musolinit, (vrrarë në burgun e Pejës, në 1946), Abdullah Shehri (po ashtu atentator në tentativë i Duces, i dënuar si ballist), botuesi Jean Gorguzi (i dënuar me burg), etj.

Mes djemve të lëvizjes komuniste në Shqipëri e Kosovë, që pas Ventotenes u angazhuan me lëvizjen dhe u vranë në luftë, ishin Emin Duraku, Skënder Caci, Xhezmi Delli, Nazmi Rushiti, Tom Kola, Lame Hito e të tjerë.

Pjesa tjetër, e dënuar në Ventotene si komuniste, u kthye në atdhe, ndihmoi në ngritjen e sistemit të ri në vend dhe u bë pjesë e arritjeve të tij. Një numër jo i vogël u kthyen në kuadrot e njohur të Ushtrisë Popullore, të Ministrisë së Punëve të Brendshme, apo ministrive të tjera në vend, të Shëndetësisë, Financave, etj., anëtarë të Partisë së Punës. Mes tyre, Ibrahim Dervishi, Xhemal Punavija, Qazim Kapisyzi e Haki Fejzo.

Të tjerë, makina e pushtetit i gllabëroi rrugës, si Abdyl Këllezi, Ahmet Jegeni, Hamid Keci, Sadik Bekteshi, Pëllumb Dishnica, Zef Mala.

Të tjerë zgjodhën të tërhiqen nga veprimtaria politike e të shkojnë një jetë të qetë.

Krijimi i tablosë së plotë të shqiptarëve të dënuar në Ventotene dhe ishujt kufitarë e më gjerë në të gjithë Italinë, në qendra të ndryshme të dedikuara, Bari, (Grumo), Perugia (Colfiorito, Monte Santa Maria Tiberina), si edhe në Shqipëri, është impenjativ.

Ai zbulon një Shqipëri të gjallë, aktive kundër pushtuesit në të gjitha nivelet, nga intelektualët, profesorët, studentët e nxënësit e shkollave, te njerëzit e thjeshtë në të gjitha anët e vendit, në malësi e në fshatra, që u internuan si opozitarë të sistemit fashist dhe u deportuan për rrezikshmëri të lartë në Ventotene.

Kjo tablo përfshin shqiptarë të njohur të kohës, brenda kufijve të Shqipërisë e pas vitit 1941, edhe nga trojet e Kosovës e Malit të Zi (me bashkimin Shqipërisë së pushtuar të trojeve shqipfolëse të Kosovës, Malit të Zi e Camërisë). Të internuarit figurojnë në dokumente administrative në dy gjuhë, italisht dhe shqip edhe pas vitit 1941, ku etnia e të dënuarve të konsideruar shqiptarë në shkresa, zgjerohet e nuk është vetëm shqiptare.

Kundërshtarët e fashizmit, të arsimuar në Perëndim, Francë, Austri, Gjermani, Itali, etj, ishin zotërues të disa gjuhëve të huaja, aktivë në jetën kulturore, politike e shoqërore në vend. Ata spikatën në ishull dhe u bënë miq të personaliteteve që punuan për Manifestin e Ventotenes, si dhe atyre që patën rol në jetën politike italiane.

Vec intelektualëve dhe studentëve e nxënësve të shkollave që kishin marrë pjesë në demonstrata antifashiste, që nuk kishin pranuar të bënin betimin fashist apo që kishin përgatitur atentat kundër Duces, në ishullin e Ventotenes zbarkuan me kostume kombëtare, disa dhjetëra shqiptarë të tjerë të thjeshtë, nga malësitë e fshatrat e vendit, po ashtu të akuzuar si kundërshtarë të rrezikshëm të regjimit fashist.

Këto ngjyrimë pulsuese të Shqipërisë së kohës ndaj pushtuesit, e zbarkuar nga 1939 në 1943 në burg me intelektualë të nivelit evropian, me djem të rinj idealistë, kundërshtarë të regjimit, me komunistë të rinj, organizatorë të lëvizjes në Shqipëri, me malësorë e fshatarë nga e gjithë Shqipëria e Kosova, me familjarë të deportuar në vende të ndryshme të Italisë apo Shqipërisë, lista e plotë emërore dhe profilet e tyre do të jenë pjesë e Ventotenes sit kujtесе.

Në të njëjtën kohë, një pjesë e mirë e këtyre profileve komplekse mund të ekspozohen në muzetë shqiptarë të Luftës së Dytë Botërore apo të regjimit komunist. Sepse shumë ka për t'u treguar në këtë vend nga të mbijetuarit e Ventotenes, Ustikës, Tremetit, Ponzës, etj.

Për këtë arsye e konsiderova të përshtatshme paraqitjen e profileve të tyre në simpozium, që përveçse trajton Shqipërinë në dy kohë, organizohet në kuadër të ditës së viktimave të regjimeve totalitare, fashizmit, nazizmit e komunizmit.

Studimi i plotë për botim do t'i trajtojë me radhë profilet antifashiste, në dritën e dy kohëve, në dy regjime totalitare, të cilat sot, për efekt të kohës së leximit, u përmendën vetëm me emra.

Nuk është rastësi që një pjesë e mirë e të dënuarve politikë në Ventotene e ishujt kufitarë konsideroheshin të dënuar nga disa regjime, sepse mendimi i lirë mbetet gjithnjë i rrezikshëm për autoritetin.